

	RREGULLORE PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	FO-MP-038
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 5</i>
<i>Departamenti: Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria</i>		



RREGULLORE PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE KOMUNALE

për vlerësimin e dëmeve eventuale gjatë ndërtimit të objekteve
elektroenergjetike të Sistemit Transmetues
(niveli i tensionit 400, 220 dhe 110 kV)


	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri	Ilir M. Shala, MSc	Fadil Ismajli	Bordi i Drejtorëve
Mbiemri	Drejtor i Departamentit për Menaxhim të Projekteve & Inxhinieri	Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT-it	të KOSTT-it
Nënshkrimi			
Data	Mars 2012		

	RREGULLORE PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	FO-MP-038
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 5</i>
<i>Departamenti: Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria</i>		

PËRMBAJTJA:

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	3
2. LARTËSIA E TARIFAVE DHE NGARKESAVE.....	4
3. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	5

S. B.

	RREGULLORE PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	FO-MP-038
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 5</i>
<i>Departamenti: Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria</i>		

Bazuar në nenin 29.2 të Ligjit për Energjinë nr. 03/ L-184, KOSTT është përgjegjës për kompensimin e dëmeve eventuale, që mund të shkaktohen gjatë ndërtimit të objekteve elektroenergjetike të Sistemit Transmetues nga ana e KOSTT-it ose kontraktuesve, që veprojnë në emër të KOSTT-it.

Kjo Rregullore synon të krijojë procedurat, të cilat lehtësojnë procesin e vlerësimit e kompensimeve të komisioneve për vlerësimin e dëmeve eventuale, që mund të shkaktohen gjatë ushtrimit të aktiviteteve të KOSTT-it si dhe sigurojë qasjen objektive në vlerësimin e kompensimit dhe kushteve të pagesës.

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1. Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e tarifave për shërbimet e veprimtarive komunale që do t'i paguajë KOSTT si kompani publike, në emër të shërbimeve komunale: vlerësimi i dëmeve eventuale për palët e treta qofshin ata persona fizikë apo juridikë, gjatë ndërtimit të objekteve elektroenergjetike të Sistemit Transmetues të nivelit të tensionit 400, 220 dhe 110 kV: linja transmetuese dhe nënstacione transmetuese.

1.2. KOSTT do të kërkojë nga Kuvendet Komunale relevante vlerësimin e dëmeve eventuale në pronat e palëve të treta, qofshin ata persona fizikë apo juridikë, gjatë ndërtimit të objekteve elektroenergjetike të Sistemit Transmetues të nivelit të tensionit 400, 220 dhe 110 kV: linja transmetuese dhe nënstacione transmetuese.


Neni 2

2.1. Pas pranimit të kërkesës zyrtare të nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it për vlerësim të dëmit ndaj palës së tretë, Kryetari i Komunës përkatëse cakton Komisionin Profesional për Vlerësimin e Dëmeve eventuale.

2.2. Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve Eventuale gjatë ndërtimit të objekteve elektroenergjetike të Sistemit Transmetues, caktohen nga Kryetari i Komunës. Për nevojat e KOSTT-it Komisioni duhet të përbëhet së paku me anëtarë si vijon:

- a) Kryetari i Komisionit – ekspert juridik
- b) Gjeometri – eksperti 1
- c) Gjeometri – eksperti 2
- d) Agronomi – eksperti bujqësor.

L. H.

	RREGULLORE PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	FO-MP-038
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 5</i>
Departamenti: Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria		

LARTËSIA E TARIFAVE DHE NGARKESAVE

Neni 3

3.1. Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.06/2008 të lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike për tarifave të shërbimeve dhe produkteve kadastrale të ofruara nga zyrat kadastrale komunale, lartësia e ngarkesave që do të paguajë KOSTT-i për Komisionet Komunale, në pajtim me këtë Rregullore do të jenë si vijon:

3.1.1. Shërbimet në Zyrë

Identifikimi i numrave të parcelave dhe pronarëve të parcelave: **10,00 EUR**
 Identifikimi i një parcele, pa matje në terren, për një parcelë: **30,00 EUR**

3.1.2. Shërbimet në Terren


Matja dhe vlerësimi i parcelave të dëmtuara: **80,00 EUR**

Një shembull konkret i llogaritjes së tarifave për Komisionin përkatës Komunal, për 50 parcela të dëmtuara:

Nr. Emri & Mbiemri	Shërbimet në Zyrë					Shërbimet në Terren				Total Shuma (EUR)
	Numri i parcelave	Identifikimi i numrave të parcelave dhe pronarëve të parcelave	Identifikimi i një parcele, pa matje në terren, për një parcelë	Subtotal 1 (EUR)	Per person	Numri i parcelave të dëmtuara	Matja dhe vlerësimi i parcelave të dëmtuara	Subtotal 2 (EUR)	Per person	
1 Kryetari i Komisionit	50	10,00	30,00	1.510,00	377,50	50	80,00	4.000,00	1.000,00	1.377,50
2 Gjeometri 1	50	10,00	30,00	1.510,00	377,50	50	80,00	4.000,00	1.000,00	1.377,50
3 Gjeometri 2	50	10,00	30,00	1.510,00	377,50	50	80,00	4.000,00	1.000,00	1.377,50
4 Agronomi/eksperti bujqësor	50	10,00	30,00	1.510,00	377,50	50	80,00	4.000,00	1.000,00	1.377,50
TOTAL										5.510,00

Neni 4

L. H.

	RREGULLORE PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	FO-MP-038
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 5</i>
<i>Departamenti: Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria</i>		

Tarifat për shërbimet komunale janë vendosur me qëllim të mbulimit të plotë të shpenzimeve, duke përfshirë shpenzimet për material dhe punë, si dhe shpenzime të tjera gjatë një periudhe mesatare të prodhimit.

Neni 5

5.1. Bazuar në Nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2008, pas paraqitjes së kërkesës nga KOSTT-i dhe para kryerjes së shërbimeve apo dhënies së produkteve të veçanta, KOSTT-it duhet t'i i bëhet një ofertë përkatëse nga ana e komunës përkatëse, me përshkrimin e shërbimeve që do të kryhen dhe kushtet e pagesës.

5.2. Përshkrimi i shërbimeve dhe produkteve nga neni 5.1 të kësaj Rregullore do të ndiqen me një deklaratë mbi pagesën dhe kushtet e përdorimit të cilën do ta lëshoj Zyra relevante Kadastrale.

Neni 6

6.1. Bazuar në nenin 19 të Udhëzimit Administrativ nr 06/2008, KOSTT-i duhet më parë ta bëjë pagesën për produktet ose për shërbimet e kërkuara nga Komisionet Komunale për vlerësimin e dëmeve eventuale për palët e treta, gjatë ndërtimit të objekteve elektroenergjetike të Sistemit Transmetues.

6.2. Pagesa do të kryhet sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësi.

3. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 7

7.1. Obligohet KOSTT-i, gjegjësisht Departamenti për Menaxhimin e Projekteve & Inxhinierisë që këtë Rregullore t'ua shpërndajë të gjitha Kuvendeve Komunale në Kosovë dhe njëkohësisht ta vëjë në tabelën e shpalljeve dhe në Ueb Faqen e KOSTT-it.

Neni 8

8.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit nga ana e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it.

L. S.